

# Info

## Epilepsia



### Epilepsia tek të moshuarit

Marramendje? Boshllëqe në kujtesë? Hutim?  
Plandosje? – ndoshta është epilepsia.

# Lidhja e epilepsisë

## Hulumton – ndihmon – informon

### Ç'është epilepsia?

Në rastin e një krize epileptike vjen deri te një çrregullim i përkohshëm i funksionit të trurit. Ekzistojnë forma të shumta të krizave epileptike. Simptomat arrijnë që nga çrregullimet e veçuara të vetëdijes në rastin e «mungesave» (krizat e vogla të përgjithshme ose Petit mal) përmes spazmave të pavullnetshme pa humbje vetëdijeje (Myokloniet) deri te krizat «e mëdha» konvulsive me vetëdije të humbur (Grand mal).

Në rastin e individëve mbi 60 vjeç, që sapo kanë nisur të vuajnë nga epilepsia, më të shpeshtat janë të ashtuquajturat kriza fokale me çrregullime vetëdijeje, të pasuara nga krizat «e mëdha», Grand mal. Tek individët e moshuar pas një krize të tillë për pak ditë paraqiten relativisht shpesh disa çrregullime të qëndrueshme në të folur ose në funksione të tjera të veçanta.

Një krizë «e madhe», e zgjatur, quhet Status epilepticus. Ajo mund të paraqitet me konvulsione, ndërsa tek të moshuarit jo rrallë mund të paraqitet edhe pa konvulsione, gjë që në fillim shpeshherë bën që të mos identifikohet si epilepsi. Pacientët duken të hutuar dhe sipas rrethanash udhëzohen nëpër klinika psikiatrike.

### Epilepsitë po bëhen sëmundje të pleqve

Pas të ashtuquajturave demenca, si për shembull sëmundja e Alzheimer-it, si dhe pikës në tru, epilepsitë janë sëmundja e tretë më e shpeshtë e sistemit nervor në pleqëri të shtyrë. Për shkak të shtimit të fortë të individëve të moshuar në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë, si dhe për shkak të mundësive gjithnjë e më të mira të trajtimit mjekësor të sëmundjeve të rënda, fillimi i një epilepsie pas moshës 65-vjeçare në ndërkohë është bërë më i shpeshtë se sa në moshën e fëmijërisë apo të rinisë. Kësisoj, epilepsitë gjithnjë e më shumë po bëhen një «sëmundje e pleqve». Për epilepsinë në pleqëri të shtyrë mund të flitet atëherë kur dy kriza të paprovokuara epileptike paraqiten në një distancë kohore prej së paku 24 orësh.

### Shkaqet

Shkaku më i shpeshtë i provuar i epilepsive të pleqërisë konsiston në çrregullimet e qarkullimit të gjakut në tru (pothuajse të çdo i dyti rast). Shkaqe të tjera të mundshme janë lëndimet e kokës, tumoret në tru, sëmundjet e demencës, sidomos sëmundja e Alzheimer-it, abuzimi me alkool ose medikamente dhe inflamacionet. Ashtu si në çdo grup-moshë, ekziston më së fundi dhe një numër i sëmurësh tek të cilët nuk provohet dot shkaktori.

Të moshuarit mund të reagojnë me ndjeshmëri shumë të lartë në rast medikamentesh të caktuara, pjesërisht edhe me uljen e pragut spazmatik - p.sh. në rastin e antibiotikëve, medikamenteve kundër çrregullimeve të ritmit të zemrës, mjeteve kundër dhimbjes (Tramadol) ose në rastin e narkozave.

### Diagnoza

Nuk është gjë e thjeshtë që të pacientët në moshën e shtyrë të pleqërisë të identifikohen krizat epileptike si të tilla. Shpeshherë për këtë shkak epilepsitë e pleqve nuk vihen re, prandaj nuk aplikohet dhe trajtimi i duhur. Ngatërresat, për shembull, janë të mundshme atëherë kur janë të pranishme sëmundje të tjera, si çrregullimet në ritmin e zemrës ose diabetes mellitus-i. Edhe çrregullimet në sjellje, të fikët (sinkopat), marramendjet ose çrregullimet në kujtesë mund të jenë indikacione për epilepsi.

Për shkak të demencës, çrregullimeve në të folur ose kufizimeve të tjera, disa individë të moshuar nuk janë në gjendje të raportojnë në mënyrë të saktë lidhur me shenjat e një krize. Nëse jetojnë të vetmuar, atëherë nuk do të ketë as familjarë që do të mund t'i përshkruanin vrojtimit e tyre.



## Trajtimi

Sapo epilepsitë e moshës së shtyrë të identifikohen një herë si të tilla, shanset për trajtim të suksesshëm, sipas rregullit, janë të mira, me kusht që medikamentet të jenë të përballueshme. Me rëndësi është dozimi i ulët dhe rritja e ngadaltë e dozës. Shpeshherë është e mjaftueshme, madje, edhe gjysma e dozave që zakonisht u jepen të rriturve të rinj. Për shkak të medikamenteve të shumta shoqëruese duhet llogaritur edhe me mundësinë e ndikimeve ndërvepruese me rrezikun e simptomave të mbidozës ashtu si dhe të uljes së efektit, madje edhe të humbjes së tij.

Pikërisht për individët e moshuar me epilepsi, disa anti-epileptikë të rinj, të mirëpërballueshëm, si Lamotrigin dhe Gabapentin, janë dëshmuar si të suksesshëm. Në të shumtën e rasteve nuk ka arsye që të prekurit e rinj nga epilepsia të heqin dorë për

këtë shkak nga jeta e tyre e mëparshme aktive dhe e pavarur. Te individët harrestarë duhet garantuar marrja e rregullt e medikamenteve. Këtu mbase ndihmon kutia përkatëse e dozimit të tabletave.

## Lista e kontrollit

- A janë vënë re shenjat e krizës, përkatësisht, të episodit?
- Përshkrimi i krizës, sipas mundësisë
- A është paraqitur kriza/episodi më shumë se një herë?
- Çrregullimet në ritmin e zemrës?
- Diabetes mellitus?
- Demenca?
- Sëmundjet e tjera?
- Medikamentet?

## Epilepsia mund të prekë këdo

Së paku pesë për qind e njerëzve gjatë jetës së tyre vuajnë nga një krizë epileptike. Afro një për qind e popullsisë sëmurët nga epilepsia gjatë jetës së tyre. Në Zvicër bëhet fjalë për 70.000 persona, midis tyre 15.000 fëmijë.

### Lidhja e epilepsisë – shumëfish aktive

Lidhja zvicerane e epilepsisë hulumton, ndihmon dhe informon që nga viti 1931. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i përditshmërisë dhe gjendjes së të prekurve nga epilepsia në shoqërinë zvicerane.

### Hulumtimi

Ajo nxit zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në të gjitha fushat e epilepsisë.

### Ndihma

Informacione dhe këshillime në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht:

- për të prekurit dhe familjarët
- për specialistët e fushave nga më të ndryshmet

### Informimi

Lidhja e epilepsisë informon dhe sensibilizon opinionin publik si dhe mbështet integrimin social të individëve të prekur nga epilepsia – si për shembull përmes kësaj broshure.

### Përpiluesi:

Dr. med. Günter Krämer

Kryetar i Lidhjes së epilepsisë 2001–2016

### Fletëpalosje të tjera në gjuhën shqipe:

Çfarë janë krizat epileptike dhe epilepsitë?

Ndihma e parë në krizat epileptike

Epilepsia dhe patentat e shoferit

### Informacione të tjera

Në gjermanisht, frëngjisht, anglisht, pjesërisht italisht:

### Schweizerische Epilepsie Liga (Lidhja zvicerane e epilepsisë)

Seefeldstrasse 84

CH-8008 Zürich

T +41 43 488 67 77

F +41 43 488 67 78

info@epi.ch

[www.epi.ch](http://www.epi.ch)

PC 80-5415-8

Gjendja e informacioneve: 2017

**Schweizerisches Rotes Kreuz**  
migesplus.ch



Me mbështetjen profesionale dhe financiare të migesplus [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) – informacione shëndetësore në shumë gjuhë

Sponsorë të tjerë: Desitin Pharma GmbH, Eisai Pharma AG, GlaxoSmithKline AG, Novartis Oncology, Sandoz Pharmaceuticals AG, UCB-Pharma AG.

Sponsorët nuk kanë ndikim në përmbajtje.